

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-191/14

Prishtinë,
6 qershor 2016

Në çështjen juridike të:

R.V.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtaret: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin (KPA30522) të datës 13.3.2014), pas shqyrtimit të mbajtur më 6 qershor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM:

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R. V., e paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014 të datës 13.3.2014, sa i përket kërkesës të regjistruar në KPCC30522.
2. Konfirmohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014 i datës 13.3.2014 për sa i përket kërkesës të regjistruar në KPCC nr. 30522.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. R. V. ka paraqitur një kërkesë si titullar i drejtës pronësore me të cilën ka kërkuar të konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit dhe riposedimin e banesës e cila gjendet në rrugën “Dr.Tot Abot Jovana” nr. 24 në Prishtinë, në sipërfaqe prej 49.50 m2.
2. Ai thekson se posedimin e banesës e ka humbur për shkak të konfliktit të armatosur në periudhën 1998/99, duke cekur datën 18.6.1999 si datën e humbjes. Kërkesa ishte regjistruar në AKP me numrin KPA 30522.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar këto dokumente:
 - Aktvendimin e GIP “Grading” Sh.A. Prishtinë, nr.01-57-92 i datës 14.6.1992,
 - Vendimin e GIK “Ramiz Sadiku” nr. 162 i datës 13.7.1979,
 - Kontratën e blerjes së banesës të vërtetuar nga Gjykata Komunale paralele E Prishtinës Vr. nr.174/2006 e datës 19.5.2006.
4. Sipas Ekipit të Verifikimit të AKP-së vendimi nr. 01-57-92 i datës 14.6.1992 është verifikuar negativisht ndërkaq, kontrata e shitblerjes Vr.nr.174 e vitit 2006 verifikimi rezultoi negativisht sepse e njëjta është vërtetuar nga Gjykata paralele, dhe vendimi nr. 162 i GIK “Ramiz Sadiku” me datë 13.7.1979, është verifikuar pozitivisht.
5. Sipas raportit të notifikimit i datës 1.4.2008,banesa është notifikuar me 1.4.2008, kjo banesë ishte e uzurpuar nga B. M. i cili paraqiti njoftimin mbi kërkesën me datë 4.1.2008, por nuk paraqiti pretendime ligjore posedimore dhe pronësore. Ndërkaq në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë është paraqitur edhe I. V., por ajo nuk paraqiti pretendime posedimore ose pronësore për këtë banesë. Ajo kërkoi që t'i lejohej të shfrytëzonte edhe më tej këtë banesë për shkak të kushteve të vështira materiale.

6. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e saj **KPCC/D/R/231/2014 i datës 13.3.2014 ka refuzuar kërkesën** e R. V.si të pabazuar. Me arsyetimin e këtij vendimi në paragrafët 68 dhe 69 konstatohet se kërkesa e tij është refuzuar me arsyetim se kontrata e blerjes e paraqitësit të kërkesës është vërtetuar nga gjykata paralele dhe për rrjedhojë nuk konsiderohet se përbën dëshmi të së drejtës pronësore. Përpos kësaj, Komisioni vëren se sipas Ligjit për marrëdhënie banesore nr. 42/86 dhe Ligjit për banesat nr. 50/92,,ai nuk ka paraqitur fakte juridikisht të vlefshme dhe nuk ka propozuar prova relevante që ka lidhur kontratën për shfrytëzimin e kësaj banese dhe që të njëjtën e kishte marrë në posedim.
7. Duke qenë se, paraqitësi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme, se ka përmbush të gjitha kërkesat përkatëse të këtij Ligji për të vërtetuar të drejtën e shfrytëzimit si dhe duke konsideruar faktin që kontrata e blerjes nuk përfaqëson dokument të përshtatshëm dhe të vlefshëm për vërtetimin e të drejtës banesore në banesën që është objekt i kërkesës.
8. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 21 maj 2014 ,kurse ka paraqitur ankesë më 11 qershor 2014.

Pretendimet e palëve:

9. Pala ankuese, R. V. pretendon se, vendimi ankimor i KPCC-së është marrë me vërtetim të gabueshëm të gjendjes faktike si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Paraqitësi i ankesës pretendon se mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur e sidomos të kontratën për blerjen e banesës nr. 194 i datës 11.12.1992 janë prova të mjaftueshme që Gjykatës Supreme që t'ia mundësojë të drejtën e shfrytëzimit në banesën që është objekt i kërkesës.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

10. Ankesa është e pranueshme, pasi është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh siç parashikohet në nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni

11. Gjykata Supreme ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.
12. Gjykata Supreme pas shqyrtimit të vendimit ankimor, shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të theksuara në ankesë sipas dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

13. Gjykata Supreme vëren se vendimi ankimor i KPCC-së është i drejtë, i plotë, i saktë, i kuptueshëm dhe përfshinë shpjegimin edhe sqarimin e të gjitha fakteve vendimtare për marrjen e një vendimi të ligjshëm. KPCC-ja me vendimin e saj ka bërë vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike mbi bazën e së cilës drejt ka zbatuar edhe të drejtën materiale kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit dhe riposedimit. Bashkëngjitur kërkesës, paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur kontratën e theksuar si dhe dokumentin tjetër provë që nuk është relevant për vendimmarrjen e kësaj çështje juridiko-banesore por edhe ato kontrata sipas Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së nuk është vërtetuar pozitivisht.
14. Gjykata Supreme gjen se vendimi i KPCC-së i nxjerrë është i drejtë, i ligjshëm, i plotë, i qartë dhe rrjedhimisht i kuptueshëm kur ka vendosur që të refuzojë kërkesën e paraqitësit të kërkesës lidhur me arsyetim se sipas Ligjit për marrëdhëniet banesore nr. 42/86 dhe Ligjit për banesa nr. 50/92 ai jo vetëm që nuk kishte paraqitur kontratën e shfrytëzimit të banesës dhe dëshminë për posedimit të pronës por që edhe kontrata e blerjes nga paraqitësi i kërkesës është vërtetuar nga një gjykatë paralele dhe për rrjedhojë nuk konsiderohet si dëshmi juridikisht e vlefshme për të vërtetuar fitimin e së drejtës së pronësisë.
15. Objekti i shqyrtimit dhe të vlerësimit të veçantë të Gjykatës Supreme ishin edhe pretendimet ankimore të ankuesit se ai në mënyrë të ligjshme ka fituar posedimin e të drejtës pronësore të banesës së kërkuar aktvendimin nr. 162 të datës 13.7.1979, aktvendimit nr. 01-57-92 i datës 14.6.1992 dhe kontratës së blerjes nr. 194 e datës 11.12.1992, por gjeti se, këto pretendime ishin të pabazuara, të papranueshme dhe rrjedhimisht të pabazë Ligjore. Kjo ngase kontrata e shitblerjes është një kontratë e vërtetuar nga gjykata paralele dhe se e njëjta nuk përfaqëson dokument të përshtatshëm, të vlefshëm për të vërtetuar të drejtën e pronësisë mbi banesën e kërkuar. Përpos kësaj aktvendimi nr. 01-57-92 i datës 14.6.1992 nuk është verifikuar pozitivisht.
16. Gjykata Supreme konsideron se në bazë të gjendjes së tillë të konstatimeve faktike pranon tërësisht dhe saktësisht qëndrimin juridik të shprehur në vendimin ankimor kur ka konkluduar se sipas Ligjit për marrëdhëniet banesore nr. 42/86 dhe Ligjit për banesa nr. 50/92 ai nuk ka paraqitur kontratën e shfrytëzimit dhe nuk e ka pasur në posedim banesën që është objekt i kërkesës, kritere këto ligjore që përfaqësojnë kusht të domosdoshëm për të pranuar të drejtën e shfrytëzimit dhe rrjedhimisht parakusht për t'iu njohur e drejta e pronës në objektin e kërkesës.

17. Gjykata Supreme konkludon se, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave pronësore me vendimin ankimor duke vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Vendimi ankimor nuk përfshin shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) nga neni 182 par. 1 dhe 2 të LPK-së, për të cilën gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare të nenit 194 të LPK dhe as atyre që janë me ndikim në drejtshëmërinë, rregullsinë dhe ligjshëmërinë e tij.
18. Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin edhe provat dhe pretendimet tjera nga ankuesi, por ato nuk ishin me ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike kontestimore
19. Në bazë të arsyeve të paraqitura e në pajtim me nenin 13.3.c të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 200 të Ligjit të procedurës kontestimore, vërtetohet vendimi i KKKPK-së dhe refuzohet ankesa si e pabazuar.

Këshillë juridike:

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Beshir Islami, Gjyqtar

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it